



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES
SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2020

TERMA REFERENCE

Për Objektin

“Sistem kondicionimi stacioner për pjesën perëndimore të ARRSH-së”.

Hyrje

Autoriteti Rrugor Shqiptar me fondin limit **7,726,871.29** lekë pa tvsh, kërkon të instalojë sistem kondicionimi stacionar në pjesën perëndimore të objektit ku ushtron veprimtarinë administrata e ARrSh.

Informacion i përgjithshëm

Objekti ndodhet në pjesën jugore të qytetit të Tiranës, rruga “Sami Frashëri”, në afërsi të liqenit artificial të Tiranës. Viti i ndërtimit 1980.

Nga pikpamja strukturore është me mure mbajtëse gjatë gjithë gjatësisë së ndërtesës dhe soleta të derdhura në vend ose të parapërgatitura, me kolona antisizmike.

Dimensionet e strukturës në plan janë (32.75x13.50), ka pesë kate me lartësi 3.33m dhe një kat nën tokë me lartësi 2.7m.

Hyrja në ndërtesë bëhet nga perëndimi.

Në vitin 2019, objekti është rikonstruktuar ku ndër të tjera për rritjen e efikasitetit të energjisë muret perimetrale janë veshur me sistem kapote, si dhe është bërë hidroizolimi i tarracës.

Objekti:

Krijimi i kushteve të përshtatshme në ambientet e objektit për një punë normale.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES
SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE

Qëllimi:

Ajo çfarë kërkohet në këto Terma Reference është “Blerje dhe instalim të sistemit të kondicionimit stacioner në pjesën perëndimore të godinës së Autoritetit Rrugor Shqiptar”.

Metodologjia.

Grupi i punës i ngritur me urdher Nr 185, date 11.09.2020, dhe Nr 6644 Prot, datë 11.09.2020, për” vlerësimin dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës, hartimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për blerje dhe instalimin e sistemit stacioner të kondicionimit për pjesën perëndimore të ARrSh-së”, për llogaritjen e fondit limit duhet të marrë oferta në treg lidhur me objektin e shërbimit për zërat e punimeve që nuk përshkruhen në manuale.

Referuar të dhënave të objektit ofertuesi duhet të llogarisë fuqinë termike në ngrohje e ftohje, numrin e njësive të jashtme dhe të brendshme, paraqitjen skematike në planimetri në shkallë 1:75 të vendosjes së njësive, sistemin e lidhjes së tubacioneve të presionit si dhe ato të kondensimit.

Të gjitha paisjet që ofertohen duhet të jenë të prodhimit të viteve të fundit, të çertifikuara sipas standarteve europiane

Për realizimin e këtij shërbimi Autoriteti Rrugor Shqiptar do të vendosë në dispozicion planimetrinë e objektit, pikën e lidhjes me energji elektrike dhe pikat e shkarkimit të kondensatit.

Bashkëlidhur janë ofertat.

Grupi i punës

Isuf Duka

Astrit Zenelaj

Edmond Bejko

Altin Sula

Gavrosh Jazexhiu

